

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

P. nr 1656/12

5 qershor 2013

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore e Prishtinës, me trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Vladimir Mikula, kryetar i trupit gjykues, gjyqtari i EULEX-it Cezary Dziurkowski dhe gjyqtarja e Kosovës Lindita Jakupi, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore të EULEX-it Emilia Viktorova, procesmbajtëse, ne rastin penal kundër:

S.L., R.X., A.A., R.H., Q.M.

të akuzuar sipas aktakuzës së ndryshuar PPS nr. 10/11 me katër akuza për veprën penale shkelje e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës, në shkelje të nenit 158, paragrafi 1 i Kodit penal të Kosovës, në lidhje me nenet 23, 25 dhe 28 të Kodit penal të Kosovës, dhe me katër akuza të veprës penale të kanosjes, në shkelje të nenit 161, paragrafët 1, 2 dhe 4 të Kodit penal të Kosovës në lidhje me nenet 23, 25 dhe 28 të Kodit penal të Kosovës.

Pas mbajtjes së seancave të procedurës paraprake më 12 dhe 20 mars 2013, dhe seancave publike kryesore të gjykimit më 15, 16, 17, 18, 19, 22, 24, 25 dhe 26 prill 2013, më 20, 21, 27, 28 dhe 31 maj 2013, dhe më 3 qershor 2013, si dhe një seancë të mbyllur më 26 mars 2013;

Pas mbajtjes së seancave të përmendura mësipër në prani të të gjithë të pandehurve dhe prokurores speciale të EULEX-it Maria Bamieh, dhe pranisë së pjesshme të avokatëve mbrojtës Arianit Koci për **S.L.**, Tahir Recaj për **R.H.**, Armend Krasniqi për **A.A.**, Sahit Bibaj për **R.H.**, dhe përfaqësuesit ligjor të palës së dëmtuar Kolë Ramaj;

Pas pleqërimit vendimmarrës të trupit gjykues dhe votimit, të mbajtur më 3 qershor 2013;

Në bazë të nenit 359, 361 dhe 366, paragrafët 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës penale, në gjykim të hapur publik, trupi gjykues lëshon këtë

AKTGJYKIM

I pandehuri **S.L.**, aktualisht në paraburgim për vepra të tjera penale, dhe i pandehuri **R.X.**, dhe i pandehuri **A.A.**,

Në bazë të nenit 364 (1), (1.1) të Kodit të Procedurës penale të Kosovës,

LIROHEN NGA AKUZA nën pikën 1

Të akuzuar sipas aktakuzës së ndryshuar PPS nr. 10/11 e 24 tetorit 2012 sipas së cilës ata dyshohen se kanë kryer veprën penale

- 1) shkelje e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës, në kundërshtim me nenin 158, par. 1 i KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së (intervista e **S.L.**)

Sepse

Në një kohë ende të papërcaktuar në maj të vitit 2009 në Kosovë, **R.H.**, A.D. dhe **A.A.** - duke qenë vendimmarrësit dhe personat më me ndikim në gazetën **xxxxxxx** – kanë rënë dakord për të bërë fushatë mediale kundër J.X. dhe stafit të saj me synim që të sulmojnë pikëpamjet e saja politike dhe shoqërore duke pasur për bazë shkatërrimin e mendimeve të ndryshme politike dhe shoqërore në shoqërinë e Kosovës, ato që konsideroheshin si jo të favorshme. Vendimi për të sulmuar J.X. ishte marrë, pasi ajo drejtonte një program televiziv në RTK, ku kishte vënë në pah keqmenaxhimin dhe kushtet e pafavorshme në Skenderaj ku **S.L.** shërbente si kryetar komune. Fushata ndaj saj ishte zbatuar përmes botimit të shpesh të artikujve në **xxxxxxx**, ku ishin përhapur gënjeshtër politike - të tilla si për shembull se J.X. është spiune serbe.

Sa i përket artikujve të botuar, në një kohë ende të papërcaktuar nga maji 2009 deri në 1 qershor 2009 në Kosovë, **S.L.** i kishte dhënë një intervistë M.K. nga Infopress, në të cilin ai - **S.L.** – e kishte akuzuar J.X. si spiune serbe, duke e ditur se një deklaratë e tillë do të publikohej nga Infopress-i (e ashtuquajtura "Intervistë me **S.L.**"). Artikulli në ballinën e gazetës paraqitet me shkronja të mëdha dhe të trasha me deklaratat e **S.L.** sipas të cilave "J.X. trupin e ka në Kosovë, por ajo punën e kryen nga Beogradi, Serbi". Mëtej thuhet se "emisione si kjo mund të bëhen vetëm nga Beogradi dhe vetëm Serbia ka bërë dhe din si të bëj kundër ushtarëve të UÇK-së" dhe se "Unë [**S.L.**] i thërras drejtorët e RTK-së që të mos i japin J.X. hapësirë në Radio Televizionin e Kosovës ". Botimi i artikullit përmbillet me deklaratën e **S.L.** se "J.X. është një shërbëto e policisë sekrete serbe".

II

I pandehuri **R.H.**, dhe

I pandehuri **A.A.**, dhe

I pandehuri **R.H.**,

Në mbështetje të nenit 364 (1), (1.1) të Kodit të Procedurës penale të Kosovës,

LIROHEN NGA AKUZA nën pikën 2

Të akuzuar sipas aktakuzës së ndryshuar PPS. No. 10/11 e 24 tetorit 2012 sipas së cilës ata dyshohen se kanë kryer veprën penale

Shkelje e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës, në kundërshtim me nenin 158, par. 1 i KPK-së, në lidhje me nenin 23 KPK ("Katër tradhtitë e J.X.")

Sepse

Në një kohë ende të papërcaktuar në maj 2009, **R.H.**, A.D. dhe **A.A.** kanë ranë dakord për të bërë fushatë mediale kundër J.X. dhe stafit të saj duke botuar respektivisht duke udhëzuar botimin e artikujve në Infopress, siç u përshkrua **akuzën nën pikën 1** të kësaj aktakuze.

Në artikullin e botuar të shkruar nga **R.H.** – me titullin "Katër tradhtitë e J.X. " – thuhej se J.X. ishte tradhtar, se J.X. ishte "e pabesë", se ajo ishte "tinëzare", se "një i pabesë nuk i zë besë askujt "dhe se J.X. ia ka shkurtuar vetes jetën. Artikulli i **R.H.** ishte botuar më 5 qershor 2009.

III

I pandehuri **R.H.**, dhe

I pandehuri **A.A.**, dhe

I pandehuri **Q.M.**,

Sipas nenit 364 (1), (1.1) të Kodit të Procedurës penale të Kosovës,

LIROHEN NGA AKUZA nën pikën 3

Të akuzuar sipas aktakuzës së ndryshuar PPS No. 10/11 të datës 24 tetor 2012 sipas së cilës ata dyshohet se kanë kryer veprën penale

Shkelje e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës, në kundërshtim me nenin 158, par. 1 të KPK-së, në lidhje me nenin 23 KPK-së ("transmetimi që terrorizoi Drenicën")

Sepse

Në një kohë ende të papërcaktuar në maj 2009, **R.H.**, A.D. dhe **A.A.** kanë rënë dakord për të bërë fushatë mediale kundër J.X. dhe stafit të saj duke botuar respektivisht duke udhëzuar botimin e artikujve në Infopress, siç u përshkrua në **akuzën nën pikën 1** të kësaj aktakuze.

Në artikullin e botuar shkruar nga **Q.M.** – të titulluar "Transmetimi që terrorizoi Drenicën", deklarohej së "raportimi dukej vërtetë si një nga ato transmetimet që Radio Televizioni i Serbisë i bënte gjatë viteve më të vështira për Kosovën, atëherë kur bëhej fushatë fashiste kundër çdo gjëje që ishte shqiptare e që u dëshmuua nga bombardimet e NATO-s që iu bënë këtij përbindëshi serb". Artikulli vazhdon duke deklaruar se "J.X. meriton "një bombë profesionale" dhe se "J.X. kishte dërguar një farë gazetarë të quajtur J.A. i e cila mua më ngjante më shumë si ata detektivët serbë të cilët vinin në Kosovë të maskuar si gazetarë përderisa realisht bënë punë policie ". Së fundi, për shkak të faktit se "shikuesit duhej të terrorizoheshin në një raportim të gjatë televiziv", J.X. "del me dy mesazhe për të cilën propaganda fashiste serbe do të kishte paguar shuma të mira parash". **Q.M.** konkludon se "e vërteta është se dikush duhet t'i tregojë J.X. se ku e ka vendin. [...] ndodhi që këtë e bëri **S.L.** e bëri këtë, dhe shumë mirë që e bëri."

IV

I pandehuri **R.H.**, dhe

I pandehuri **A.A.**, dhe

Sipas nenit 364 (1), (1.1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës,

LIROHEN NGA AKUZA nën pikën 4

Të akuzuar sipas aktakuzës së ndryshuar PPS nr. 10/11 të datës 24 tetor 2012 sipas së cilës ata dyshohen se kanë kryer veprën penale

Shkelje e statusit të barabartë të banorëve të Kosovës, në kundërshtim me nenin 158, par. 1 i KPK-së, në lidhje me nenin 23 të KPK-së ("Lufta për ambasadë-horr")

Sepse

Në një kohë ende të papërcaktuar në maj të vitit 2009, **R.H.**, A.D. dhe **A.A.** kanë dakord për të bërë fushatë mediale kundër J.X. dhe stafit të saj duke botuar respektivisht duke udhëzuar botimin e artikujve në Infopress, siç specifikohet në pikën 1 të kësaj aktakuze.

Në artikullin e botuar me titullin "Lufta kundër kurvës së ambasadës" të shkruar nga R.S. – person ky që nuk ishte kontaktueshem nga PSRK-ja - deklarohej se "për një kohë në Kosovë ne shohim pseudo-gazetarë që veprojnë si gazetarë. Gazetarët e emisionit "Jeta në Kosovë" [...] kanë hyrë në garë për të fituar titullin e "kryekuzhinierit", kusht ky i kërkuar nga kuzhina

e specializuar e Beogradit e quajtur B92. [...] Duket se kurva e ambasadës J.X. ishte e pa konkurrence për të merituar këtë titull. [...] Në çfarëdo pjese të botës [...], cilido 'gazetar' po të bënte atë që e ka bërë kjo kryekuzhinierë do të ishte hequr dhe dënuar për veprime kundër-shtetërore[...] Kurva të tilla ambasadash dhe kryekuzhinierë të tillë të USB- së duhet ta dinë se ajo çfarë po bëjnë ata nuk do të mbetet krejtësisht e padënueshme. [...] Kur zyrtarët shqiptarë në Kosovë të kenë përmbushur obligimet e tyre për të mbrojtur simbolet kombëtare dhe shtetërore nga përdhunimi i kurvave të ambasadave të B92-shit, atëherë shqiptarët e përkushtuar marrin të gjitha të drejtat për të dënuar kurvat e ambasadave si terroristë. Duket se ajo ditë nuk është aq larg [...]. Çfarë do të thoshte moderatori i RTK-së nëse një shqiptar i përkushtuar e dënon pasardhësen e H.S., kurvën e ambasadës J.X. në Prishtinë? Do të isha i nderuar po t'i shtrëngoja duart me këtë shqiptar të përkushtuar."

V

I pandehuri **S.L.**, dhe

I pandehuri **R.H.**, dhe

I pandehuri **A.A.**,

Sipas nenit 364 (1), (1.1) të Kodit të Procedurës penale të Kosovës,

LIROHEN NGA AKUZA nën pikën 5

Të akuzuar sipas aktakuzës së ndryshuar PPS nr. 10/11 të datës 24 tetor 2012 sipas së cilës ata dyshohen se kanë kryer veprën penale

Kanosje, në kundërshtim me nenin 161, par. 1, 2 dhe 4 të KPK-së, të lexuar së bashku me nenin 23 të KPK-së (Intervista e **S.L.**)

Sepse

Duke iu referuar përshkrimin në akuzën nën **pikën 1, S.L.** i është kanosur J.X. padrejtësisht dhe pa paraqitur asnjë dëshmi, duke e akuzuar se ishte spiune serbe, duke e ditur se kjo deklaratë do të botohej në Infopress dhe duke e ditur gjithashtu se bazuar në rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë, një deklaratë e tillë do të rrezikonte seriozisht mirëqenien e saj si dhe do t'i shkaktonte ankth dhe frikë. **M.K., R.H., A.D.** dhe **A.A.** e kanë përcjellë më tej këtë deklaratë dhe e kanë botuar më 2 qershor 2009 në Infopress, duke e ditur se përhapja e një deklarate të tillë në publik do të vente në rrezik jetën e J.X. dhe të ekipit të saj si dhe do t'i frikësonte ata, do t'u shkaktonte atyre ankth dhe do t'i vendoste ato në kushte të rënda për një periudhë të gjatë kohore. Kërcënimet e bëra nga **S.L.** e të botuar nga **R.H., A.D.** dhe **A.A.** kanë rezultuar në kërcënime me vdekje kundër J.X. dhe ekipit të saj dhe kanë shkaktuar ankth të madh dhe të vazhdueshëm tek ata.

VI.

I pandehuri **R.H.**, dhe

I pandehuri **A.A.**, dhe

I pandehuri **R.H.**

Sipas nenit 364 (1), (1.1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës,

LIROHEN NGA AKUZA nën pikën 6

Të akuzuar sipas aktakuzës së ndryshuar PPS nr. 10/11 nga data 24 tetor 2012 sipas së cilës ata dyshohen se kanë kryer veprën penale

Kanosje, në kundërshtim me nenin 161, par. 1, 2 dhe 4 të KPK-së, i lexuar së bashku me nenin 23 të KPK-së ("katër tradhtitë e J.X.")

Sepse

Duke iu referuar përshkrimit në pikën 2, **R.H.** i është kanosur J.X. padrejtësisht dhe pa paraqitur asnjë dëshmi dhe duke e akuzuar se është "tradhtare", një "tradhtare", "e pabesë" dhe "tinëzare". **R.H.** drejtpërdrejtë e ka kërcënuar J.X. me vdekje duke deklaruar se ajo "po ia shkurton jetën vetes". **R.H.** e ka ditur se deklaratat e tija do të shiheshin si kërcënime kundër jetës dhe mirëqenies së J.X., gjë kjo që i ka shkaktuar asaj ankth dhe frikë.

R.H., A.D. dhe **A.A.** e kanë botuar deklaratën e H. më 1 qershor 2009, në Infopress, duke e ditur se përhapja e një deklaratë të tillë në publik do të vinte në rrezik jetën e J.X. dhe të ekipit të saj si dhe do t' i frikësonte ata, do t' u shkaktonte atyre ankth dhe do t' i vendoste ato në kushte të rënda për një periudhë të gjatë kohore. Kërcënimet e bëra nga **R.H.** dhe të botuara nga **R.H.** A.D. dhe **A.A.** kanë rezultuar në kërcënime me vdekje kundër J.X. dhe ekipit të saj dhe kanë shkaktuar ankth të madh dhe të vazhdueshëm tek ata

VII

I pandehuri **R.H.**, dhe

I pandehuri **A.A.**, dhe

I pandehuri **Q.M.**,

Sipas nenit 364 (1), (1.1) të Kodit të Procedurës penale të Kosovës,

LIROHEN NGA AKUZA nën pikën 7

Të akuzuar sipas aktakuzës së ndryshuar PPS nr. 10/11 e datës 24 tetor 2012 sipas së cilës ata dyshohen se kanë kryer veprën penale

Kanosje, në kundërshtim me nenin 161, par. 1, 2 dhe 4 të KPK-së, të lexuar së bashku me nenin 23 KPK (“Emisioni që terrorizoi Drenicën”)

Sepse

Duke iu referuar përshkrimit të bërë në akuzën nën **pikën 3**, **Q.M.** i është kanosur padrejtësisht **J.X.** dhe pa paraqitur asnjë dëshmi duke e akuzuar atë se ka shfrytëzuar metoda transmetimi të cilat “Radio Televizioni i Serbisë i ka bërë gjatë viteve më të vështira për Kosovës” dhe se **J.X.** dhe stafi i saj – përfshirë edhe **J.A.** – dukeshin si detektivë serbë të cilët bënin punën e policisë serbe. **Q.M.** drejtpërdrejtë e ka kërcënuar **J.X.** me vdekje duke deklaruar se ajo meriton një “bombë profesionale”. **Q.M.** e ka ditur se deklaratat e tija do të shiheshin si kërcënime kundër jetës dhe mirëqenies së **J.X.**, gjë kjo që i ka shkaktuar asaj ankth dhe frikë.

R.H., **A.D.** dhe **A.A.** e kanë botuar deklaratën e **Q.M.** më 30 maj 2009 në Infopress, duke e ditur se përhapja e një deklaratë të tillë në publik do të vinte në rrezik jetën e **J.X.** dhe të ekipit të saj si dhe do t’ i frikësonte ata, do t’ u shkaktonte atyre ankth dhe do t’ i vendoste ato në kushte të rënda për një periudhë të gjatë kohore. Kërcënimet e bëra nga **Q.M.** dhe të botuara nga **R.H.**, **A.D.** dhe **A.A.** kanë rezultuar në kërcënime me vdekje kundër **J.X.** dhe ekipit të saj dhe kanë shkaktuar ankth të madh dhe të vazhdueshëm tek ata

VIII.

I pandehuri **R.H.**, dhe

I pandehuri **A.A.**, dhe

Sipas nenit 364 (1), (1.1) të Kodit të Procedurës penale të Kosovës,

LIROHEN NGA AKUZA nën pikën 8

Të akuzuar sipas aktakuzës së ndryshuar PPS nr. 10/11 e datës 24 tetor 2012 sipas së cilës ata dyshohen se kanë kryer veprën penale

Kanosje, në kundërshtim me nenin 161, par. 1, 2 dhe 4 të KPK-së, të lexuar së bashku me nenin 23 KPK (“Lufta kundër kurvave të ambasadës”)

Sepse

Duke iu referuar përshkrimit të bërë në akuzën nën **pikën 4, R.H., A.D. dhe A.A.** kanë botuar padrejtësisht kërcënimet kundër J.X. dhe duke mos paraqitur asnjë dëshmi e kanë quajtur J.X. një ‘kurvë ambasdash’ që ka hyrë “në garë për të fituar titullin e "kryekuzhinierit", kusht ky i kërkuar nga kuzhina e specializuar e Beogradit e quajtur B92. [...] dhe duke specifikuar më tutje se J.X. i shërbente titullit “kurvë ambasdash”. **R.H., A.D. dhe A.A.** kanë botuar kërcënime të drejtpërdrejta kundër mirëqenies fizike të J.X. duke deklaruar se në “çfarëdo vendi të botës “ [...] “ ajo do të hiqej dhe dënohej për veprime anti-shtetërore”. Kërcënimi vazhdon me terma të tillë si “Kurva të tilla ambasdash dhe kryekuzhinierë të tillë të USB- së duhet ta dinë se ajo çfarë po bëjnë ata nuk do të mbetet krejtësisht e padënueshme. [...] dhe se “ shqiptarët e përkushtuar i kanë të gjitha të drejtat për t’i dënuar kurvat e ambasadave si terroristë.” Sipas këtij botimi, dita e dënimit të J.X. ishte deklaruar si shumë e mirëpritur “nuk është shumë larg [...].

R.H., A.D. dhe A.A. i kanë botuar deklaratat e tilla me 5 qershor 2009 në Infopress duke e ditur se përhapja e një deklaratë të tillë në publik do ta vinte në rrezik jetën e J.X. dhe të ekipit të saj si dhe do t’ i frikësonte ata, do t’ u shkaktonte atyre ankth dhe do t’ i vendoste ato në kushte të rënda për një periudhë të gjatë kohore. Kërcënimet e bëra dhe të botuara nga **R.H., A.D. dhe A.A.** kanë rezultuar në kërcënime me vdekje kundër J.X. dhe ekipit të saj dhe kanë shkaktuar ankth të madh dhe të vazhdueshëm tek ata

Sepse veprat për të cilat akuzohen të pandehurit nuk përbëjnë vepra penale

SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE

Sipas nenit 454 (1) të Kodit të Procedurës penale, shpenzimet e procedurës penale lidhur më të gjithë të pandehurit do të paguhen nga fondi buxhetor.

ARSYETIM

I. Rrethanat procedurale

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve të mësipërm për veprat e supozuara penale Shkelje e statusit të barabartë të banorëve në Kosovë sipas nenit 158 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës ("KPK") dhe Kanosje sipas nenit 161 paragrafët 1, 2 dhe 4 të KPK-së. Këto vepra penale ishin të përfshira në aktakuzën e ndryshuar të datës 24 tetor 2012. Prokurorja e ndryshoi aktakuzën e saj të mëparshme të datës 15 gusht 2011 sipas aktvendimeve të Gjyqarit për konfirmim të aktakuzës dhe trupit prej tre gjykatësve. Gjykata vazhdoi me aktakuzën në pajtim me kodin e ri të procedurës penale në fuqi nga 1 janari 2013 në pajtim me nenin 541 të këtij kodi. Seanca e parë dhe e dytë nuk u mbajtën për shkak se këto u zëvendësuan në mënyrë të mjaftueshme me

procedurën e konfirmimit të aktakuzës të mbajtur në përputhje me kodin e vjetër të procedurës penale në fuqi deri më 1 janar 2013.

II. Provat

Provat vendimtare janë përmbajtja e artikujve të caktuar dhe titujt e tyre të botuar në mbarë Kosovën nga e gazeta e përditshme "Infopress". Këto janë:

- 1) Komenti i **Q.M.** botuar më 30 maj 2009 (faqet 5-7, kutia e dëshmive, versioni anglisht)
- 2) Intervista me të pandehurin **S.L.** botuar më 2 qershor 2009 (në faqet 32-34, kutia e dëshmive, versioni anglisht)
- 3) Komenti i **R.H.** botuar më 5 qershor 2009 i quajtur "Katër tradhtitë e J.X." (faqet 39-40, kutia e provave, versioni anglisht)
- 4) Komenti i **R.S.** botuar më 5 qershor 2009 (faqet 47-48, kutia e dëshmive, versioni anglisht). Për qëllime të këtij aktgjykimi, intervistës me **S.L.** do t'i referohemi me fjalën "artikulli".

Provat me shkrim gjithashtu përfshinin një vendim të Këshillit të Mediave sipas të cilit artikujt e botuar nga "Infopress-i" konsideroheshin të jenë në kundërshtim me kodin e mediave duke e gjobitur kështu "Infopress-in" në vlerë prej 1000 Euro. Gjykata gjithashtu pati mundësinë ta shohë tërë emisionin " J.X. xxxxxxxx " në lidhje me këtë çështje, si dhe reklamat për gazetën "Infopress" të cilat u transmetuan para lajmeve të mbrëmjes në kanalin e RTK-së ku citoheshin ekstrakte të artikujve të sipërpërmendur.

Deklaratat e dëshmitarëve

J.B. (procesverbali i dëgjimit të tij më 26 mars 2013 i mbajtur jashtë shqyrtimit gjyqësor)

J.B. iu referua takimit të tij me gazetaren J.A. dhe kritikave që ai kishte për situatën në Skenderaj. Fjalët e tij u transmetuan dhe u bënë arsye për problemet e tij që pasuan me udhëheqjen komunale, gjë e cila çoi tek shkarkimi i tij nga puna në xxxxxxxxxxxxxxxx. Ai gjithashtu theksoi se nga përvoja e tij, njerëzit që etiketoheshin si spiunë serbë ishin të diskriminuar dhe vriteshin herë pas here. Në mënyrë të veçantë, ai iu referua vrasjes së S.X. nga fshati xxxxxxxx në vitin 1995 dhe vrasjes së dy vëllezërve në qendër të qytetit të Skenderajt.

J.X. (procesverbali i shqyrtimit kryesor i datës 15-16 prill 2013)

Pala e dëmtuar J.X. deklaroi se është prezantuese e programit më të shikuar në Kosovë "J.X. xxxxxxxx " (në anglisht "xxxxxxx"), program ky i cili mirret me tema problematike dhe tabu në shoqërinë kosovare. Ajo është gjithashtu xxxxxxxx BIRN Kosova (Rrjeti ballkanik për gazetari hulumtuese). Një nga emisionet e "J.X. xxxxxxxx " i ishte dedikuar premtimeve të

kryetarëve të komunave në Kosovë. Një kamermane dhe reporterja J.A. u dërguan në Skenderaj të pyesë njerëzit në lidhje me këtë temë. Ata kishin folur me politikanin e opozitës J.B. Ekipi i RTK-së nuk u mirëprit në Skenderaj dhe njerëz anonimë duke ua treguar atyre armën i kishin urdhëruar ekipin ta fikin kamerën. Ata ishin larguar nga Skenderaj me përcjellje të policisë. Kjo kishte ndodhur në mars të vitit 2009. Raporti u transmetua më 28 maj 2009. Dëshmitarja pranoi se raporti nuk ishte aspak pozitiv për rajonin e Skenderajt. Reagimi i mediave erdhi në radhë të parë nga "Infopress-i". J.X. përmendi reagimet në faqet e internetit dhe adresën e saj email të cilat ajo në atë kohë i konsideronte si reagime të zakonshme si ndodhte pas transmetimit të disa temave kontroverse. Pas një botimi të shtunës të gazetës "Infopress", ajo mori ende më shumë email-a të cilët përmbanin gjuhë të ngjashme me artikullin e "Infopress-it". *Ajo citoi email-a përmbajtja e të cilëve mund të vlerësohet vetëm si shumë kërcënuese (shih kutinë e gjykatës 1, pika 31).* Ajo deklaroi se konsideron se të jesh i etiketuar si spiun serb në shoqërinë e pasluftës në Kosovë ishte thirrje për linçim, sidomos në titujt e shkrimeve të tilla. Sipas J.X., **S.L.** me intervistën e tij i kishte mobilizuar përkrahësit e tij të pasionuar. Si fjalët më kërcënuese J.X. i konsideron ato të komenteve të **R.H.** siç janë, "*Jeta ia bëri vetes të mos ketë jetë të gjatë*", dhe këto fjalë i ishin drejtuar asaj personalisht dhe nuk kishin të bëjnë me programin televiziv. Ajo e justifikoi këtë interpretim duke deklaruar se po të kishte menduar **R.H.** në programin televiziv, ai do e kishte përdorur formën mashkullore. J.X. përmendi reagimet e OJQ-ve të ndryshme të cilat konsideronin artikujt e tillë si sulm ndaj lirisë së fjalës. Ajo akuzën se "*J.X. është një shërbëtore e policisë sekrete serbe*" e konsideron se mund të paraqesë kërcënim ndaj saj. Ajo përmendi emrat e gazetarëve të cilët ishin kërcënuar për punën e tyre, konkretisht V.K. i cili ishte kërcënuar nga S.G., ish-ushtar i UÇK-së, me akuzat se ai po shkruante kundër UÇK-së, dhe H.M. i cili ishte rrahur në rrugë dhe ishte quajtur tradhtar pasi që kishte shkruar kundër veteranëve të UÇK-së. Kjo kishte ndodhur në vitin 2000. J.X. deklaroi se dy gazetarë nga "Bota Sot" ishin vrarë. Në mesin e tyre ishte B.A. i cili, gjashtë muaj para se të vritej, shkroi një kolumne në lidhje me krimet e kryera nga ushtarët dhe para se të vritej ishte etiketuar si spiun serb. Ishte edhe B.K. i cili ishte edhe gazetar i gazetës Bota Sot dhe i cili ishte vrarë në vitin 2001. Katër gazetarë të gazetës Bota Sot ishin të mbrojtur nga UNMIK-u për katër vjet me radhë sepse ishin të etiketuar si bashkëpunëtorë të serbëve. Ajo deklaroi se stafi i RTK-së ishte subjekt i fjalëve fyese dhe u ishin pështyrë. Ajo deklaroi se pas botimit të gjithë këtyre artikujve, asaj i ishte reagimi i saj. Ajo kishte reaguar në faqet e internetit të BIRN-it. Ajo deklaroi se kishte ndikim tjetër në publik, kur titujt e atyre komenteve u lexuan në lajmet televizive.

A.M. (procesverbali i shqyrtimit kryesor i datës 17 prill 2013)

A.M. deklaroi se edhe për të thuhej se ishte spiun serb gjithashtu. Ai tha se nëse dikush etiketohet spiun kjo është të etiketohesh si tradhtar. Të quhesh tradhtar është akuza më e rëndë për një njeri. Kjo është "njollosje" e madhe në Kosovë. Kjo ka ndikim mbi të gjithë familjen dhe është e rrezikshme në veçanti nëse bëhet nga njerëz të fuqishëm dhe/ose njerëz

me ndikim. Ai tha se kishte pasur kërcënime nga **S.L.** dhe njerëzit e tij. Pas luftës në komunën e tij, ishin vrarë disa njerëz, në mesin e tyre një gazetar, por këto raste nuk ishin zgjidhur dhe ai nuk mund të supozonte se pse ishin vrarë. Ai hodhi poshtë etiketimin që i ishte bërë J.X. si spiune për shkak se J.X. vjen nga familje e respektuar. Ai kishte punuar për xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx nga xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx (jo nga viti xxxxxxxx deri xxxxxxxxxxxxxxxx, kur këtë pozitë e kishte xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx), kur **S.L.** e kishte larguar atë nga puna në mënyrë të paligjshme. Gjykata e kishte rikthyer atë në punë por **S.L.** nuk e kishte ekzekutuar atë vendim. Ai tha se është absurditet i madh që dikush të akuzohet se është spiun serb tani që Kosova është e lirë dhe Serbia nuk është këtu. Pastaj ai përdori një metaforë për etiketimin e dikujt si spiun serb. Kjo i ngjan asaj kur në mal ju e bëni gati drurin të cilin duhet prerë dhe është çështje e momentit kur ato dru duhet prerë.

H.M. (procesverbali i shqyrtimit kryesor i datës 18 prill 2013)

Ai tha se punon si gazetar që 30 vjet, duke përfshirë edhe katër vjet për xxxxxxxx xxxxxxxx. Ai tregoi se ka përjetuar përvojën e të qenurit i sulmuar por ai nuk ishte shumë i gatshëm t'i lidhë këto sulme me artikujt që i kishte shkruar. Edhe kur ishte kërcënuar pas botimit të artikujve kundër veteranëve të UÇK-së, kurrë nuk e kishte ndjerë veten si jo të lirë në punën e tij. Ai megjithatë deklaroi se edhe pse ai u quajt spiun serb apo tradhtar, kjo gjë kurrë nuk e kishte prekur. Ai nuk e konfirmoi faktin se gazetarët a janë vrarë apo rrahur, për shkak të etiketimit si spiun serb. Ai e konsideron etiketimin e tillë fyerje. H.M. deklaroi se nga përvoja e tij, kolumnisti është përgjegjës për kolonën e vet, kryeredaktori për lajme, raportim, kurse shefin i ditës për titujt. Ai deklaroi se ka një rritje të përdorimit të fjalëve si tradhtar, bandit, agjent i UDB-ës, punëtor i SHIK-ut në jetën e përditshme në Kosovë.

J.A.(procesverbali nga shqyrtimi kryesor i datës 18 prill 2013)

J.A. ishte gazetare hulumtuese që punonte për emisionin "J.X. xxxxxxxx ", e cila në moshën xxxxxxxx bëri një raportim nga Skenderaj në lidhje me premtimet e kryetarit të komunës dhe përmbushjes së premtimeve, të cilat dy ose tre muaj më vonë u transmetuan si pjesë e emisionit në lidhje me lirinë e fjalës të cilin e drejtonte J.X.. Raportimi i saj nuk kishte për cak popullin e Skenderajt dhe të Drenicës siç u keqinterpretua nga autorët e komenteve, dhe se asaj i është dashur t'iu shpjegojë miqve dhe kolegëve të saj se raportet nuk ishin kundër Drenicës, por kryesisht pa sukses. Pas botimit të artikujve, ajo e ndjente armiqësinë ndaj saj. Njerëzit në rrugë e quanin spiune. Ajo kishte pasur një aksident me makinë ku një makinë e kishte goditur makinën e saj dhe kishte ikur. Kur kishte lënë punën në BIRN pas këtyre incidenteve, ajo kishte punuar si xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx. Ajo nuk është diskriminuar në tregun e punës. Ajo këmbënguli se raporti i saj ishte shumë i balancuar.

T.E.J.(T.J.) (shqyrtimi Kryesor nga data 18 Prill 2013)

T.J. ka deklaruar se jeton ne Londër por ai është korrespondent i revistës “Economist” për Ballkanin. Ai ka kaluar shume kohe ne Ballkan duke përfshire Kosovën. Ne vitin 1995 ai është kthyer ne xxxxxxx por ka vazhduar te kaloje shume kohe duke e mbuluar Ballkanin, përfshire edhe Kosovën, luftën ne Kosove dhe kohen e pasluftës. Ai ka shkruar një libër mbi historinë e Serbeve dhe dy libra për Kosovën. Ai ka deklaruar se nëse ndonjë person (ne Kosove) është pare te jete kolaborator me Serbet jeta e saj do te ishte nen kërcënim. Kjo vetëm ka mundur te shihet nga viti 1998 kur personat e pare qe kishin vdekur gjate konfliktit ishin Shqiptar te vrare nga vet Shqiptaret sepse ata ishin pare nga Shqiptaret si kolaboracionist Serb. Kjo ka vazhduar pas lufte gjithashtu kur shume Kosovar Shqiptar besohet se ishin kidnapuar dhe vrare, edhe pse kjo është njëfarë teme tabu ne Kosove. Atij i kujtohet se ka qene një periudhe kur persona te partisë se LDK-se, partisë se Ibrahim Rugovës, ishin vrare. Ka pasur gazetar qe ishin vrare ndoshta edhe për arsye politike. Nëse ne vitin 2009 ndonjë person është quajtur tradhtar apo spiun Serb, ndikimi qe do te kishte ne jetën e atij personi, mjaft ndaras nga demet qe do te shkaktonte ne reputacionin personal dhe profesional, ai ka menduar se një lloj i tille akuzave ka mundur te krijojë një klime te shtytjes qe ka qene seriozisht kërcënuese për jetën. Ne te vërtete, ne atë kohe shokët e Kosovës nga jashtë kane menduar se kjo ishte brengosëse sa qe ne jemi mobilizuar te alarmojmë sa me shume njerëz qe ishte e mundur sepse ata kane dëshiruar te sigurohen se kjo klime e shtytjes do te rezultonte ne jo-dhune dhe nivelet me te larta ishin involvuar dhe informuar.

Kur një gazetar e etiketon ndonjë person si spiun, si spiun Serb pa pasur asnjë dëshmi sa me te vogël te mbështete një pretendim te tille do te paditej menjëherë ne ligjin civil për përgojim apo shpifje. Nëse ai thotë diçka qe është e pavërtetë rreth ndonjë personi ai do te supozonte se do te ishte padi civile. Mirëpo, ne një moment te caktuar, nëse ka kaluar kufijtë ne shtyrje për vrasje atëherë qarte do te ishte vepër penale. Por ai nuk ishte ne gjendje ti tregoj Gjykatës se ku është vija. Ne kontekst te Kosovës kjo mund te interpretohet ose si shtytje ne vrasje ose mënyre e qetimit te njerëzve qe nuk i keni ne qejf, dhe mënyre e shkatërrimit te karrierave. Akuzat e J.X. janë bere si lajme ndërkombëtare dhe shume shoke te Kosovës jashtë vendit janë alarmuar dhe janë mobilizuar sepse ata kane dashur te alarmojnë sa me shume njerëz qe është e mundur ne mënyre qe lajmet te shkojnë ne Kosove sepse ata janë frikësuar se asaj do ti ndodhe diçka. Pastaj ai ka prezantuar një shembull. Ne Britaninë e Madhe, ne 1170 Mbreti është ankuar rreth Kryepeshkopit te Canterbury. Mbreti ka thënë, ” kush do ta largoje këtë prift problematik?” Ne ate moment Kryepeshkopi është vrare dhe mbreti ka thënë se nuk ka pasur asgjë te beje me atë dhe ai nuk ka menduar se duhet te vritet. Kështu qe për mija vjet është e qarte se çka tregojnë akuza te tilla dhe ai nuk mendon se ne Kosove është ndryshe. Duke konsideruar rrethanat ne Kosove dhe ne Ballkan, nëse e etiketon një gazetar si spiun Serb, tradhtar apo kuzhinier për kuzhinat Serbe kjo do te ishte një spektër nga një ane ne tjetrën dhe ai mendon se ne skenarin me te keqe do te ishte mire e kuptueshme si shtytje për dhune por ne minimumin e saj do te kuptohej

për te shkatërruar kredibilitetin e gazetarit ne fjale. Ai nuk mund te japë një shembull ne gazetari por e din se njerëzit madje dhe ne 1998 te cilët kanë punuar ne pozita te modeste si ne pylltari janë vrare sepse ata janë konsideruar bashkëpunëtor. Ai ka deklaruar se kur gazetaret janë vrare ne ish-Jugosllavi kjo mistrie kurrë nuk është zgjidhur dhe ai supozon se ne këtë rast Kosova nuk është ndryshe nga Kroacia apo Serbia. Ne Kosove duket te jete njëjte si ne vende tjera.

T.J. e ka lexuar përkthimin e artikullit te shkruar nga **R.H.** dhe ai e ka kuptuar këtë. Ne fillim, **R.H.** flet rreth J.X., mirëpo deri ne kohen kur **R.H.** arrin ne paragrafin 2, pa ia sqaruar atë lexuesit, ai flet rreth J.A. Për ndonjë arsye, autori flet për “ajo” por ai nuk ia sqaron lexuesit se ka kaluar prej J.X. ne J.A. Sipas dëshmitarit autori i referohet J.X. sepse J.X. natyrisht se është shoqëruar ne te gjitha senset me ‘J.X. xxxxxxxx’ edhepse ne mënyre hutuese. T.J. ka deklaruar se madje edhe ne vitin 2009 te akuzohesh si spiun Serb ka qene një akuze shume e fuqishme dhe e rrezikshme. Ai ka deklaruar se popullata kane besuar se ka qene ne interes patriotik te tyre te eliminohen tradhtar te caktuar ne mesin e tyre. Ai ka deklaruar se ne çfarëdo suate pas konflikti, ne çfarëdo vendi, gjithmonë do te këtë njerëz te cilët janë mentalisht te dëmtuar nga traumat e tyre dhe ne këtë kontekst mund te vendosin se veprimi i drejte për tu hakmarrë humbjeve te veta do te ishte te eliminojnë ndonjë person si J.X.. Kjo do te ishte e njëjte ne çfarëdo suate pas konflikti.

H.G. (shqyrtimi Kryesor nga 24 Prill 2013)

Dëshmitari e ka kontestuar vërtetësinë e pjesën ne lidhje me premtimet e Kryetarit te Komunës.

B.H. (procesverbal i Shqyrtimit Kryesor nga 25 Prill 2013)

Ai është xxxxxxxx i Shoqatës se Gazetareve Profesional. Ne xxxxxxxx ai ka qene xxxxxxxx i “xxxxxxx”. Ne Shkurt xxxxxxxx ai ka punuar si xxxxxxxx i “xxxxxxx”. Ai e njeh **S.L.** një kohe te gjate dhe ata i kane pasur baticat dhe zbaticat me mospajtime dhe ata nuk kane raport te ngushte me njeri tjetrin. Ai ka përvoje nga lufta me **S.L.** dhe ne atë kohe kur ata kane qene ne rrethana te tensionuar, duke iu referuar fillimit te Shkurtit 1999. Ai ka thëne se Kosova është njëra nga disa regjionet e Ballkanit ku bie ne gjumë si patriot dhe kur zgjohesh jeni tradhtar. Ai ka thëne se ai është quajtur kolaborator Serb, përmes media, nga S.P. (xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx). Me vone S.P. i ka kërkuar falje dëshmitarit dhe ai ka thëne se kjo është mënyra me e lehte për ta shkatërruar ndonjë person ne Ballkan. Konteksti socio-ekonomik ne Kosove përcakton akuzat. Normalisht nëse një Serb ka thëne se personi është colaborator kjo do te shkaktonte me shume dem se sa këtë ta bënte ndonjë vendor. Pastaj ai ka vazhduar se deklarata e **S.L.** ne interviste ka qene e papërgjegjshme ne nivelin e saj te larte. Faqes se pare te “Infopress” i ka munguar profesionalizmi. Kur personi e jepe një deklaratë publike dhe ai i përket institucionit shtetëror atëherë ai duhet ta gjeje mënyrën qe vepra penale mos te jete shihet aq qarte siç është para ne “Infopress”. Ai ka deklaruar se gazetari menaxhues nuk mund te censuron personin publik por mund te plase gjuhen e përdorur. Ekziston mundësia qe J.X. te jete plagosur nga artikulli i “Infopress” se paku shpirtërisht dhe ai do te mbështetet plotësisht J.X. dhe për atë te parashtroje padi ne Gjykate për arsye te përdorimit te gjuhës se

padurueshme. Një gazetar me përvojë si J.X. nuk është dashur ta lëndojë profesionin duke e angazhuar prokurorin për ndihmë. Gazetari ka njohuri për të marrë një Avokat Mbrojtës dhe të paraqesë padi civile dhe nuk është mirë të identifikohet me shtet.

Ai gjithashtu ka deklaruar se ekziston një lende që është definuar si vrasje e gazetarit. Gazetari i vrare ka qene gazetar i gazetës “Bota Sot” por ai nuk mund të thotë se a është vrare për shkak të profesionit të tij apo për diçka tjetër. Fjalinë nga artikulli i **R.H.** se “J.X. ia ka bere veti që ajo të ketë jete të shkurtër” ai nuk do ta merrte seriozisht. Ai gjithashtu ka definuar “Fushatën”. Sipas tij fushate quhet mbledhja e fakteve të qëndrueshme për të neutralizuar fuqinë e ndonjë personi i cili në opinionin publik ndërton një karrierë për mes falsifikimeve apo mashtrimeve. Kurse fushate pozitive është kur ju dëshironi apo keni dëshirë të dërgoni popullatës informacione dhe dëshironi ta bindni popullatën se diçka është për të mirën e tyre.

Deklaratat e të Pandehurve

R.H. (Shqyrtimi Kryesor nga 26 Prill 2013)

R.H. ka deklaruar se xxxxxxxxxxxxxxxx “Infopress”. Ai ka qene xxxxxxxx për afro një vit dhe xxxxxxxxxxxxxxxx. Ai ka thënë se fizikisht nuk ka qene në “Infopress”, dhe ai nuk ka zyre atje. Drejtor Gjeneral i “Infopress” në atë kohë ka qene A.D. dhe përgjegjësia xxxxxxxx ka qene administrata, marketingu dhe financat. Seksioni editorial ka qene i përbërë prej gazetarëve, redaktorit dhe krye-redaktoret. Ai ka konfirmuar se në kohën në fjale xxxxxxxx i kompanisë/organizatës ligjore, pronar i gazetës “Infopress” dhe gjithashtu si person që ka vepruar në emër të kësaj organizate ligjore. Ai nuk është paraqitur për 2-3 muaj në lokalet e “Infopress”. Ai kurrë nuk i ka parë artikujt e J.X.. Ai e ka kritikuar përkthimin e artikujve në aktakuzë. Ai ka treguar se prokuroria e ka ndryshuar konotacionin e fjalëve të shkruara në artikuj.

S.L. (Shqyrtimi Kryesor nga 20 Maj 2013)

Ai ka deklaruar se në kohën e regjimit të Milosheviqit ai është dënuar me njëzet vjet burg. Ai ka pasur probleme me Serbet por vetëm me Shërbim të Inteligjencës dhe Qeverinë. Ai ka deklaruar se i ka kërkuar falje publikisht J.X.. Ai e sheh ndërlidhjen ndërmjet faktit se BIRN (*Balkan Investigative Reporting Network*) është regjistruar në Beograd dhe Shërbimi Serb i Inteligjencës gjithashtu është i bazuar në Beograd. Ai e ka shprehur përvojën e tij se gazetarët kanë punuar si informues. Ai nuk beson se fjalët e tij e kanë kërcënuar J.X.. Ai e konsideron programin rreth premtimeve të Kryetarit të Komunës së Skenderaj si provokues, jo të balancuar dhe të papranueshëm dhe që i preke shumë njerëz në Skenderaj por ai kurrë nuk e ka kontaktuar drejtorin e RTK-së në lidhje me këtë program. Ai nuk beson se sulmet ndaj J.A. dhe J.X. kanë qene aq të rënda sa që ato të kishin ndikim të ato me një intensitet siç është përshkruar nga ato. Ai ka pohuar se email-at kërcënues janë shkruar për J.X. nga vet ajo. Ai ka pranuar se fjalët “spion” apo “kolaborator” përdoren në baza ditore.

A.A.(Shqyrtimi Kryesor nga 20 Maj 2013)

Ai ka thënë se i njeh të gjithë autorët e artikujve të cilët janë subjekt i aktakuzës përveç **R.H.** Ai ka punuar për “Infopress” prej Gusht 2006 deri në Tetor 2011. Në një kohë të caktuar ai është caktuar si Redaktor. Ai ka thënë se ata janë konsultuar nganjëherë me **R.H.** rreth disa çështjeve por **R.H.** nuk ka qene fizikisht në zyrë të “Infopress”. “Infopress” funksionon mbi parimin ku krye-redaktori së bashku me kolegjin vendosin çka të shtypin në faqen e parë. Me vonë Brenda deklaratës së tij ai ka pohuar se ka qene kolegj që ka vendosur çka do të shtypet në faqen e parë. Anëtarët e kolegjit kanë qene redaktore. Ai ka thënë se është informuar paraprakisht se **Q.M.** do ta dërgojë artikullin për publikim. Ai ka thënë se e njeh **Q.M.** si një gazetar të respektuar kështu që ai nuk ka menduar se artikulli i tij do të prishte disa rregulla. Opinione që i kanë marrë ata janë dërguar me email. Ai refuzon të besojë se të përgojosh ndonjë person në 2009 si spiun Serb mund të jete kërcënim. Ai e ka mohuar se e ka aprovuar publikimin e artikullit “Lufte për një lavirë të Ambasadës” të R.S.. Ai nuk e ka parë kërcënimin në fjalinë e artikullit “Jeta e ka shkurtuar jetën e saj” të **R.H.** sepse ka pasur të bëjë me programin “J.X. xxxxxxxxxxxxxxxx”

Q.M. (Procesverbal i Shqyrtimit Kryesor nga 21 Maj 2013)

Q.M. ka deklaruar se ka xxxxxxxxxxxxxxxx xxxxxxxxxxxxxxxx. Ai ka qene gazetar, redaktor i gazetës së xxxxxxxx “xxxxxxx”, gazetar, redaktor dhe zëvendës-redaktor i gazetës për të rinj “xxxxxxx”, sekretar për gazetën xxxxxxxx “xxxxxxx”, gazetar dhe redaktor në xxxxxxxx, korrespondent për xxxxxxxxxxxxxxxx, gazetar dhe krye-redaktor për xxxxxxxx, gazetar dhe redaktor i xxxxxxxx kur edhe është themeluar. Ai ka kontribuar nganjëherë në BBC e nganjëherë në Deutsche Welle, gazetën xxxxxxxx dhe xxxxxxxx..

Ai ka besuar se diçka është dashur të thuhet në lidhje me programin e J.X. sa i përket premtimet e Kryetarit të Komunës së Skenderajt. Ai ka shkruaj rreth kësaj teme. Ai e ka kritikuar përkthimin e artikullit të tij nga gjuha Shqipe në Anglisht. Ai i ka bazuar kritikën e tij në disa fakte: J.X. nuk ka arritur apo hyrë në TV Kosova si institucion përmes një konkurrence siç është e rregulluar dhe siç duhet të jete. Shihet qartë se ajo demonstroi një arrogancë të padurueshme në disa programe të saj. J.X. belbëzon, pështyn dhe lavdërohet në emër të lirisë së shtypit por në fakt ajo është shembulli më brutal i fjalës së dhunshme dhe e shkeljes së lirisë së fjalës.

Ai e mohon armiqësinë e tij ndaj J.X.. Ai sqaron se kritika e tij ka qene i shenjestruar ndaj J.X. si moderator sepse një person i tillë duhet të jete subjekt i kritikës publike. Programi i saj rreth Drenicës i ngjanë atyre programeve nga koha e regjimit Serb. Programi jepe përshtypjen apo reflekton tone të ngjashme. 30% e territorit verior nuk është i kontrolluar nga Qeveria e Kosovës; 30% e territorit ku gjendet Drenica nuk kontrollohet nga Qeveria. Porosia kyçe e programit ka qene kjo sipas tij dhe kjo ka qene arsyeja pse ai ka reaguar ashtu. Ai ka deklaruar se liria e fjalës është e shkelur në Kosovë por jo nga **Q.M.** por nga klanet politike, nga klanet e interesit dhe nga një sere strukturash të organizuara dhe gazetaria në Kosovë nuk ka bere asgjë për të penguar këto grupe. Sa i përket këtij artikulli ai ka thënë se polemika nënkupton një gjuhë të ashpër por ai është kërenar me faktin se ky artikull nuk përmban fjale ofenduese. Ai ka menduar se ky artikull i ka shprehur pjesë të opinionit publik që e janë ndier të ofenduar nga programi i J.X.. Ai nuk beson se J.X. dhe J.A. janë sulmuar. Ai ka besuar se është sulmuar programi i tyre. Ai nuk beson se njerëzit që e kanë lexuar këtë artikull mund të shkruajnë emaila të tilla kërcënuese siç janë

pranuar nga J.X.. Ato emaila janë shtytur nga ndonjë person tjetër. Ai mohon çfarëdo bashkëpunimi me te pandehurit tjerë.

R.H. (Shqyrtimi Kryesor nga 21 Maj 2013)

Ai ka deklaruar se nuk është gazetar i “InfoPress”. Motivi i këtij artikulli ka qene programi (J.X. xxxxxxx), veçanërisht raportimi nga Skenderaj. Ai është ndier i ofenduar dhe i tradhtuar nga stacioni TV shtetëror dhe është ndier i tradhtuar nga ”J.X. xxxxxxx”. Ne atë pjese te raportimit ai ka pare njëanshmëri dhe ka vërejtur se Drenica si regjion është dukur te jete diçka ndryshe nga pjesët tjera te Kosove. Ai thjesht është ndier i ofenduar dhe është ndier se ka mundur te tregoj dhe te shprehe ndjenjat e tij dhe te tregoj se si është ndier rreth transmetimit përmes këtij artikulli. Ai ia ka dërguar mendimin e tij pese gazetave. Gjate tere jetës se tij ai i ka shkruar 5-6 opinione te ndryshme dhe ai zakonisht ia dërgon ato te gjitha gazetave. Ai nuk ka qene i paguar apo kontraktuar ne “Infopress”. Ai e kupton se kur futet një fjale ne thonjëza kjo nuk e pranon domethënien e pare, ne këtë rast “tradhtar” si tradhtar shtetëror apo ne nivele tjera te familjes personi qe e tradhton familjen. Sipas tij kjo nuk është ne domethënien klasike. Kjo fjali ne artikull “J.X. ia ka bere veti qe ajo te ketë jete te shkurtër” është tërësisht e ndërlidhur apo e menduar ne lidhje me programin ”J.X. xxxxxxx”. Ai ka deklaruar se njeriu duhet te jete i çmendur te beje një kërcenim për jete ne mënyre aq te hapur. Ai ka sqaruar se ne Shqip përdoret shprehja për ndonjë person apo diçka “ai/ajo nuk e ka gjate”. Fjalët dhe shprehjet si “nuk shkon me tutje” përdoren ne metafora dhe cinizëm. Ai nuk i kishte lexuar ato nga artikujt e mëhershëm te gazetave. Ne datën e pjesa raportuese është transmetuar ai ka qene jashtë vendit. Ai nuk ka pasur njohuri se “InfoPress” domosdoshmërisht e mbulonte çështjen. Qëllimi i tij nuk ka qene te prezantoje këtë si një lloj mbrojtje për **S.L.** dhe as qe i ka shkruar mendja se dikush do ta merrte këtë si një sulm kundër dikujt tjetër. Atij i vjen keq se J.X. është ndier ashtu siç është ndier. Ai ka deklaruar se ne Shqip programi nuk mund te jete “ajo” apo “ai” por ”J.X. xxxxxxx” specifikisht mund te referohet si “ajo”. Ndoshta dikush ka mundur ti lexoje dhe kuptoje gabimisht pjesët e ndryshme te tekstit. Kjo është një çështje personale individuale varësisht nga lexuesi. Ai nuk ka pasur kurrfarë mënyre ti referohet J.X. sepse një gazetar tjetër ka qene ne terren dhe kjo shihet qarte. Ai ka deklaruar se ekziston një ndërlidhje ndërmjet ”J.X. xxxxxxx”, J.X. dhe J.A.. Ai e ka adresuar konceptin “J.X” si një koncept.

Vleresimi i provave

Deklarata e J.B.

J.B. iu është referuar vrasjeve te spiuneve te pretenduar Serb nga 1995 deri 2000 te cilat nuk janë hetuar me mënyre te suksesshme. Deklarata e tij fare nuk ka ndriçuar ne pyetjen e rëndësishme kur dikush etiketohet si “spion Serb” apo disi ndryshëm me domethënie se personi është tradhtar i Shqiptareve ne shërbim te Serbeve. Ai e ka vërtetuar njohurinë e përgjithshme te vrasjeve te njerëzve me arsyen e pretenduar se ata ishin spiun Serb por vetem ne kohen e konfliktit.

Deklarata e J.X.

Paneli nuk e sheh ndonjë lidhje ndërmjet email-eve kërcënuese dhe artikullit të “Infopress”. Një artikull i tillë mund të shkaktojë urrejtje ndërmjet qytetareve, veçanërisht kundër personit si J.X., që merret me tema të tilla kontroverse. Urrejtja kundër J.X. gjithashtu ka mundur të shkaktohet me raportimin nga Skenderaj apo me raporte tjera të saj. Ky koment nuk mund të konsiderohet si shtytje për dhune kundër J.X.. Gjykata qarte ka përdorur interpretime gjuhësore të komentit. Konotacionet tjera nuk janë vërtetuar. Autorët e emaileve kërcënuese nuk janë gjetur për tu intervistuar në lidhje me lidhjen e emaileve dhe komenteve të tyre dhe intervistës së S.L. Inspirimi dhe guximi i treguar në artikullin e Q.M. mund të nxjerre një përfundim por ky fakt nuk është përcaktuar me dëshmi. J.X. i konsideron fjalët me kërcënuese nga komenti i R.H. si “J.X. ia ka bërë vetes që mos të ketë jete të gjate” dhe kjo është një kontradikte me pohimin e autorit se ai iu është referuar programit. Vetëm pse ai nuk e ka përdorur formën mashkullore nuk do të thotë automatikisht se ai ka pasur qëllim kërcënimi kundër J.X.. Interpretimi i një artikulli të tillë duhet të bazohet në faktin se autorët kanë punuar me hiperbola dhe i tere konteksti është shumë hiperbolik. Gjykata nuk konsideron se artikulli i hiperbolikisht i helmët automatikisht nënkupton një kërcënim. Në anën tjetër përdorimi i gjuhës hiperbolike dhe metaforike e forcon ndikimin e reputacionit të J.X..

Deklarata e A.M.

A.M. ka folur në mënyre të vazhdueshme rreth përvojës së tij me S.L.. Gjykata nuk ka hezitim rreth vërtetësisë së tij edhe me përvojën e tij të keqe me S.L.. Deklarata e tij mbështet opinionin e Gjykatës rreth ndryshimit të ambientit në shoqërinë në Kosovë prej kohës së luftës dhe ndryshimin logjik të domethënies së fjalëve “Spiun Serb”.

Deklarata e H.M.

H.M. e ka dhënë opinionin e tij si gazetar i cila ka pasur përvoja të sulmit dhe është e qarte nga deklarata e tij se të quhesh spiun i Serbeve është sulm në disa rrethana. Ai në përgjithësi ka deklaruar se fjalët e tilla janë të shpeshta në realitetin e jetës në Kosovë. Deklarata e tij mbështet argumentet e tij se artikujt kanë qenë ofendues dhe shpifëse por jo kërcënim.

Deklarata e J.A.

Intervista e J.A. ka treguar se artikujt negativisht kanë influencuar reputacionin e saj dhe integritetin psikologjik por jo pozitën e saj në tregun e punës. Deklarata e saj mbështet faktin se artikujt kanë qenë ofendues. Deklarata e saj është mbështetur nga V.D., kamermane, e pranishme në incidentin në Skenderaj (*Shqyrtimi Kryesor nga 19 prill 2013*).

Deklarata e T.J.

T.J. ka filtruar informata nga qarqet e afërta me palën e dëmtuar dhe është e evidente se ai me pa dashje ka marrë perceptimin e tyre. Ai pjesërisht i ka kualifikuar artikujt si subjekt të shpifjes. Deklarata e tij rreth seriozitetit të pretendimit të tilla si thirrje për urrejtje janë në kundërshtim me deklaratat e H.M. dhe B.H., të cilët janë gazetar lokal dhe të cilët gjithashtu janë sulmuar për

shkrimet e tyre kontroverse. Ai gjithashtu ka pranuar se nuk është ne gjendje te definoj atë se ku përfundon shkelja e ligjit civil dhe ku fillon shkelja e ligjit penal.

Deklarata e B.H.

Edhe pse B.H. është paralajmëruar se nuk është quajtur ekspert, përvoja e tij si gazetar i Kosovës ka qene e frytshme për te kuptuar disa fakte te realitetit ne Kosove. Ai nuk ka konsideruar se artikujt te tille ofendues meritojnë intervenim shtetëror dhe se gazetari duhet ta zgjedhe atë ne kontekstin civil. Deklarata e tij korrespondon me deklaratën e H.M..

Dëshmi shtese-e vlerësuar

Fjalori/Përkthimi

Gjykata e ka konfrontuar përkthimin e fjalës “Horr” te gjuhës Shqipe, e cila ne aktakuze është përkthyer nga gjuha Shqipe “pun” apo loja me fjale “ “ambassadhorr” si “embassy slut-lavire ambassade alb. ”. Sipas fjalorëve Shqip-Shqip nga viti 1981 publikuar nga Rilindja, ne Prishtine “horr” dmth; 1. Personi me zakone te këqija qe sillet keq, pine alkool dhe luan bixhoz; person pa nder; njeri i rrugëve, rrugaç. Shembull: horr i horrave, (*a very bad man-angl.*). 2. njeri shume i varfër; person pa asnjë cent ne xhep qe mbijeton me shume pak te ardhura. 3. Njeri shume i pasur por shume zemërngushte, aspak bujar; dikush qe ka pasuri por ai nuk i jep aspak tjerëve por vet jeton shume keq. Shembull: një horr *deca* e ka share një person shume keq; e ka turpëruar një person dhe e ka denigruar shume keq një person. Sipas një fjalori tjetër, autor i te cilët është Mikel Ndreca, publikuar nga Botuese Toena, 2007, Tirane. Definicioni i gjetur ne faqe 259. Termi “horr” d.m.th.: 1. Person me zakone te këqija dhe pa nder; rrugaç. . 2. Njeri i varfër. 3. Njeri shume i pasur por zemërngushte. Kjo është ne kontradikte me fjalorin e Oxfordit i cili fjalën “horr” e përkthen si lavire. Gjykata pranon përkthimin e bute sepse te përdoret fjala si “lavire” ne një gazete serioze është kundër logjikes se zakonshme. Këto probleme me përkthim vetëm ilustronë nevojën e Gjykatës qe te ketë një vështrim me te thelle te realitetit ne Kosove dhe kjo eshte arsyeja pse Paneli e ka konsultuar lenden me Ombudspersonin e Kosoves.

Raportet e RTK

Raportet rreth premtimeve te Kryetarit te Komunës si shkaktar dhe teme e këtyre artikujve janë lëshuar ne Shqyrtimin Kryesor për te kuptuar motivin e artikujve siç janë prezantuar nga te pandehurit-autoret. I tere programi rreth lirisë se fjalës i moderuar J.X., ne te cilin është futur raporti gjithashtu është lëshuar ne Shqyrtimin Kryesor.

Raportet kane qene ne lidhje me premtimet e Kryetarit te Komunës. Duhet te ceket se e tere përshtypja nuk ka qene pozitive për menaxhmentin e Komunës dhe ka qene tërësisht i pa-balancuar. Kjo është shkaktuar me zgjedhjen e personave te intervistuar dhe gjithashtu me konkludimin dramatik kur ekipi i J.A. e ka përshkruar se atë e kane përcjellë me veture dhe ajo i ka përkujtuar emocionet e saj por nuk ka pasur te beje me temën kryesore. Gjithashtu edhe përgjigjet pse nuk janë plotësuar disa premtime nga ana e komunës nuk janë prezantuar. Gabimi me i madh ka qene se ky raportim i pa balancuar është futur ne diskutim për lirinë e fjalës kështu

qe është forcuar një përshtypje e vogël negative për Skenderaj. E tere përshtypja ka qene se diçka nuk është ne rregull ne Skenderaj por ne anën tjetër ka qene shume vështire për shikuesit televiziv te identifikojnë se çka ishte specifikisht. Gjykata ka cekur këtë qe ne shikim te pare është dëshmia jo e rëndësishme sepse reagimi nga ana e gazetareve, S.L. dhe lexuesit e “Infopress” ka qene jo adekuate. Raportet objektivistike kane merituar kritika por jo aq te ashpra, reagim te forte qe sulmon integritetin social dhe psikologjik te autoreve dhe te ekipit. Një reagim i tille jo adekuat krijon përshtypjes se “diçka qëndron mbrapa saj”. Kjo “diçka mbrapa saj” nuk është vërtetuar. Do te thotë se Gjykata, ne kundërshtim me aktakuzën konsideron te gjithë artikujt si një iniciative individuale e autoreve te cilët janë ndier te prekur sepse vlerat e jetës se tyre individuale janë sulmuar nga këto raporte (shiko poshtë ne paragrafin ‘Fakte te pavërtetuara’).

IV. Kërkesa e palës se Dëmtuar

Sa i përket kërkesës se J.X., se pari, Gjykata shënon se deri ne fund te seancës J.X. nuk ka bere asnjë kërkesë për kompenzim dëmi. Ajo i ka propozuar Gjykatës qe ta referon kërkesën e saj procedurave civile. Gjykata nuk ka kompetenca për te referuar këtë lende procedurave civile. Prandaj, Gjykata nuk vendos mbi kërkesa te tilla civile.

V. Parashtrësit e palëve.

Gjykata i ka pranuar te gjitha propozimet për dëshmi nga palët.

VI. Vlerësimi Ligjor

Gjykata ka qene e lidhur ne vlerësimet e saj nga aktet e përshkruara ne aktakuze. Përshkrimi i akteve vetëm i ka cituar pjesët e artikujve dhe titujve Kryesor te artikujve kështu qe këto pjese te cituara ne aktakuze janë vlerësuar nga këndvështrimi i përgjegjësishë penale por i tere artikulli është marre ne konsiderate. Aktet janë vërtetuar ne tërësi (shiko me poshtë). Gjykata ka hetuar e kualifikimi ligjor i akteve nuk është identik me kualifikimin ligjor ne aktakuze. Gjykata ka hetuar se fjalët fyese ne secilin artikull/koment janë vepër penale unike.

Bashkëpunimi penal ndërmjet te pandehurve nuk është vërtetuar. Te pandehurit kane vepruar ndaras. Gjykata nuk i sheh si fushate këta katër artikuj te publikuar brenda një jave. Nga deklaratat e te pandehurve kuptohet se janë shkruar katër artikuj si reagim spontan ndaj programit “J.X. xxxxxxx”. Nuk është vërtetuar asnjë marrëveshje preliminare apo marrëveshje e nënkuptuar ndërmjet te pandehurve. Ekzistojnë disa tregues te cilët tregojnë se prokuroria mund te flasë rreth bashkëpunimit sepse disa nga te pandehurit e kane njohur njeri tjetrin, apo vija kohore e lëshimit te artikujve ne disa gazeta, por nuk është e mjaftueshme te konkludohet se ka pasur bashkëpunim ndërmjet te pandehurve.

Vepra penale e Kërcënimit kërkon te njëjtat elemente si ne Kodit e vjetër Penal (i vlefshëm deri me 1 Janar 2013) dhe Kodit te Ri Penal. Aktet janë kryer ne kohen e vlefshmërisë se kodit te vjetër. Kërcënimi mund te kryhet me fjale direkte, me gjeste, porosi dhe gjithashtu edhe ne manure indirekte duke përdorur simbole te mirënjohura ne disa nen-kultura (laps i zi, veshje pule dërguar palës se dëmtuar). Fjalët ofenduese te përdoruara ne artikuj nuk e kane shprehur kërcënimin ne mënyre direkte. Gjykata nuk e ka hetuar nëse dikush quhet spiun i Serbeve ne

Kosove ne 2009 te jete një porosi e fshehte kërcënimi. Gjykata shume mire ka pasur njohuri për historinë moderne te Kosoves dhe një denoncim i tille konsiderohet si shume ofenduese dhe si sulm psikologjik, social dhe ekonomik i integritetit te viktimës. Dëshmia nuk e ka vërtetuar faktin se fjalët e përdorura ne artikuj kane pasur porosi te fshehta kërcënuese ndaj palës se dëmtuar. Gjykata i ka kualifikuar fjalët ne komentet e **Q.M., R.H., R.S.** si një sulm. Fjalët **S.L.** te thëna ne interviste janë fyese. Gjuha hiperbolike dhe metaforike e këtyre tre autoreve e ka ndikimin e sulmit por logjikisht sepse një hiperbole e ekzagjeruar nuk mund te konsiderohet si shpifje. Duhet te thuhet se profesioni i gazetarisë si dhe shkrime tjera ne aktivitetin e tyre social nuk janë penalisht përgjegjëse për ofendim sipas nenit 187 par.1, nen-par. 1 te Kodit te vjetër penal. Gjithashtu duhet te thuhet se nga 1 Janari 2012, ofendimi dhe përgojimi nuk janë më vepra penale. **S.L.** ka pohuar ne intervistën e tij ne mënyre demonstrative fakte te pavërteta rreth lidhjes ndërmjet J.X. dhe shërbimit sekret te Serbisë. Tentimi për te vërtetuar se për shkak se zyrat e BIRN është gjithashtu ne Beograd dhe nga ajo arsye ai e quan J.X. spiune te Serbisë nuk mund te qëndrojnë. Akti i **S.L.** është kualifikuar nga Gjykata si fyese por edhe akti i **S.L.** ka përfituar nga kodi i ri penal. Nëse aktet nuk janë me vepra penale atëherë Gjykata nuk merret me përgjegjësinë penale te pandehurit. Përgjegjësia e te pandehurve **R.H.** dhe **A.A.** për artikujt e autorit i cili nuk ka mundur te gjendet, R.S. është dashtë për të arritur ne përfundim nga e ashtuquajtura përgjegjësi kaskad ne rastin e veprës penale te kryer përmes media (Neni 28 i mëparshëm i kodit te vjetër penal, gjithashtu i aprovuar ne kodin e ri por i anuluar ne kodin e ri me 2012/04-L129) i cili nuk është i aplikueshme nga 1 Janar 2012. Prandaj duhet te ceket se ne lidhje me **R.H.**, ekziston edhe një arsye tjetër për lirim dhe pronari i gazetës sipas kodit te ri dhe te vjetër, veçanërisht ne kodin e ri, nuk mund te jete përgjegjës për një artikull. Pasi që veprat penale të “fyerjes” dhe “shpifjes” nuk janë pjesë e kodit penal më, Gjykata nuk është marrë me pyetjet e tjera më pak të rëndësishme /të akteve dhe të vlerësimit nëse aktet e tilla meritojnë intervenim të pushtetit publik/shtetëror. Duhet të përmendet që e drejta civile në Kosovë në mënyrë shteruese rregullon marrëdhëniet e të drejtës civile ndërmjet qytetarëve dhe subjekteve juridike në atë mënyrë është relevante për palët e dëmtuara në këtë lëndë.

Në rastin e **A.A.** si kryeredaktor i cili mund të jetë përgjegjës për titujt si autor i kësaj, gjykata duhet të cekë se përgjegjësia e tij për shtypjen e titujve të tillë nuk është vërtetuar. Deklarata e tij e mohon faktin se ai madje as nuk i ka lexuar se çfarë tituj janë zgjedhur. (Këto vepra penale nuk kanë pandehur përgjegjësi neglizhuese dhe objektive të kryeredaktorit, fjala është për ligjin civil).

Vepra penale Shkelja e Statusit të Barabartë të Banorëve të Kosovës (kodi i vjetër penal) dhe shkelja e Statusit të Barabartë të Qytetarëve dhe Banorëve të Republikës së Kosovës (kodi i ri penal) në parim mbron trajtimin e barabartë të personave e siguruar nga Rendi Kushtetues i Kosovës. Prokuroria e sheh qëllimin e autorit të artikujve për të ndaluar aktivitetet gazetareske dhe të kufizojë të drejtën e J.X. dhe stafit të saj të lirisë së fjalës. (Nëse gjykata do të pranonte konstruktin ligjor të ndjekjes kjo do të ishte një vepër penale e mundshme e tentimeve për të nxitur persona të panjohur për të eliminuar aktivitetet gazetareske të J.X.). Një thirrje e tillë është edhe shprehje e lirisë së fjalës. Të pandehurit donin të shprehnin mendimin e tyre në lidhje me punën gazetareske të J.X. dhe ekipit të saj. Vepra penale Shkelja e Statusit të Barabartë të

Banorëve të Kosovës, shërben për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave. E drejta për shprehje publike është zgjerimi i lirisë së fjalës. Gazetarët mund të kritikojnë gazetarët tjerë haptazi. Thirrja publike në një mënyrë të tillë hiperbolike që të përjashtojnë J.X. nga puna gazetareske është krejtësisht legjitime por vetëm mënyra e kritikës së tillë është në pyetje.

Faktet e dëshmuara

Gjykata e konsideron si të dëshmuar se artikujt / komentet / opinionet janë shkruar nga të pandehurit. Megjithatë, komenti i R.S. është një përjashtim, sepse ai nuk është i akuzuar. Gjykata nuk ka dyshime se **S.L.** ishte autori i intervistës. Gjykata e konsideron si të dëshmuar përmbajtjen e këtyre intervistave dhe artikujve që kanë të bëjnë me palën e dëmtuar, J.X. dhe programin e RTK-së "J.X. xxxxxxxx" dhe J.A..

Faktet e pa dëshmuara

Gjykata ka gjetur se nuk është dëshmuar që këta artikuj janë fushatë e kryer në bashkë kryerje dhe se janë bërë me akte individuale dhe aktivitete të secilit të pandehur. Gjykata ka analizuar përmbajtjen e këtyre artikujve dhe nuk ka gjetur se përmbajtja e këtyre artikujve është kërcënim i koduar. Ne nuk kishim çelësin e këtij kodi. Asnjë dëshmitar e asnjë provë materiale nuk ka vërtetuar se etiketimi i dikujt si bashkëpunëtor i Serbisë është një kërcënim. Megjithatë ajo që është gjetur është se këta artikuj kanë prekur nderin dhe reputacionin e J.X.. Këta artikuj ishin fyes dhe shpifës. Çka nuk është gjetur është lidhja në mes të postave elektronike (e-mail) dërguar J.X. dhe aksidentit me makinë ku përfshihej J.A. si dhe lidhja në mes të këtyre artikujve. Gjykata nuk mund të thotë se ata ishin të nxitur nga kryesit e këtyre postave elektronike dhe në shqyrtimin kryesor, gjykata nuk ka mundur të gjejë se ata ishin frymëzuar nga autorët e këtyre postave elektronike.

VII. Përfundim

Vendimi i gjykatës është tërësisht i bazuar në vlerësimet ligjore të gjykatës.

Kryetari i Trupit Gjykses:

Gjyqtari i EULEX-it

Vladimir Mikula

Procesmbajtës

Natasa Malesevic

Këshillë Juridike: Në pajtim me Nenet 380 dhe 381 të Kodit të Procedurës Penale, personat e autorizuar kanë të drejtë të paraqesin ankesë kundër Aktgjykimit aktual brenda 15 ditësh nga dita kur kopja e Aktgjykimit është shërbyer. Çdo Ankesë duhet të dorëzohet pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës.